



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesues i KD-së
Prof. dr. Ismet Salihu

Nr. Prot.: 3/692
Datë: 5/12/2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", pas shqyrtimit të Kërkesë Nr. 3/672 dt. 31.10.2017, të parashtruar nga Xhafer Dragusha, ish zyrtar teknik/për asete në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, për kompensim të pagave pas pensionit, Në mbledhjen e mbajtur me datën 02.11.2017 merr, këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa e Xhafer Dragushës, ish zyrtar teknik/ për asete në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për kompensimin e pagave pas pensionimit dhe atyre të shpërblimit jubilar.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është përfundimtar për organet e UP-së.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 2. 11. 2017, pasi shqyrtoi kërkesën Nr. 3/672 dt. 31.10.2017, të parashtruar nga Xhafer Dragusha, zyrtar administrativ për asete në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, për kompensimin e tri pagave jubilarë dhe tri paga për përcjellje pas pensionimit, ku i përmenduri ka arrite moshën e pensionimit më 28.8.2015 dhe me vendimin nr. Prot: 1/15 dt. 14.05.2017 është njoftuar se në bazë të RREGULLOREN NR. 33/2012 PËR SHITESAT NË PAGË DHE KOMPENSIME TË TJERA TË NËPUNËSVE CIVILË, Neni 19 pika 2 përcakton kompensimin pas pensionimit ku i takon vetëm një page, andaj edhe të përmendurit ju është njohur e drejta e një page në vlerë të pagës së fundit. KD-konsideroi se kontrata kolektive nuk ka karakter obligativ dhe atë duke u mbështetur në praktikën e institucioneve të tjera shtetërore të cilat nuk e kanë zbatuar asnjë herë kontratën kolektive të punës, sepse një kontratë e tillë e nënshkruar në mes partnerëve social ka kërkuar edhe ndarjen e kostos së lartë buxhetore, të cilën qeveria e Kosovës nuk e ka paraparë për asnjë institucion. Gjithashtu Kontrata Kolektive e nënshkruar në mes SBASHK dhe MASHT me nr. prot: 2056 e datës 18.4.2017, i parasheh vetëm të punësuarit para universitar dhe jo shërbyesit civil, si dhe në Dispozitat kalimtare neni 46 pasi që të sigurohen fondet nga Qeveria e Republikës së Kosovës përkatësisht MF. Prandaj pa një planifikim paraprak buxhetor për këtë destinim, të ndarë nga institucionet nuk mund të realizohen kërkesa të tilla, si dhe asnjë vendim individual për kompensim sipas asnjë kontratës kolektive, nga ajo që u theksua më lartë dhe mbi këtë bazë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës kompetente në afat prej 15 ditësh nga pranimi (në kopje fizike apo elektronike) të këtij vendimi.

Ky vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Parashtruesit të Kërkesës;
3. Asistentit të KD-së;
4. Zyrës Ligjore të UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Prof. dr. Ismet Salihu – Kryesues